



2-D/DPK

Nr Prot. 01-689/13


Br Prot. 01-689/13

Data 07-03-2013

Datum 07-03-2013

02

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 19.02.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2434/12, për ztr. Nexhemdin Kastrati – Zavendës Ministër në Ministrinë e Administratës Publike të Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2434-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Nexhemdin Kastrati – Zavendës Ministër në Ministrinë e Administratës Publike të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajftushmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Kastrati, është paraqitur, në takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Nexhmedin Kastrati ka deklaruar se do të filloj procedurat e ndryshimit të kësaj gjendje, konform Ligjit për parandalimin e konflikti të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

Meqense ky ndryshim ka zgjatur, atëherë Agjencioni Kundër Korrupsionit, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit të lartë i ka dërguar edhe shkresën e dytë.

Pas shkresës së dytë nga Agjencia (Z.D./DPK-01-4344/12), që ndryshe quhet Paralajmërim, zyrtari i lartë, ztr. Krasniqi, ka bërë ndryshimet e nevojshme duke shuar në mënyrë vullnetare krejt biznesin e tij, dhe duke vazhduar ta kryej vetëm funksionin e vet publik si Zvendës Ministër në Ministrinë e Administratës Publike të Kosovës.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, Agjencinë Kundër Korrupsionit, nepërmes ztr. Kastrati ka pranuar informacion zyrtar nga ARBK-ja, me informacionet e reja mbi biznesin "Qendra e Marketingut" (DPK/DPKI-03-264/2013), në të cilat shihet se ai biznes, tashmë, është shuar në mënyrë vullnetare.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

